



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Politikave dhe Programeve Ndërkombëtare

**BURSA STUDIMI PËR STUDENTË, PEDAGOGË DHE STAFE ADMINISTRATIVE
NË UNIVERSITET EUROPIANE, NË KUADËR TË PROJEKTIT
“ERASMUS MUNDUS”**

Basileus V dhe *Join EU-SEE*, dy partneritete të projektit “**Erasmus Mundus**” shpallin programin e bursave për studentë, pedagogë dhe stafe administrative në kuadër të shkëmbimeve (mobilitetit) ndërmjet universiteteve partnere europiane, ku përfshihet edhe Universiteti i Tiranës.

Në kuadër të këtyre shkëmbimeve, për “*Basileus V*” dhe “*Join EU-SEE*” mund të aplikojnë:

1. Studentë të Universitetit të Tiranës ose të një universiteti tjetër partner i Europës duke filluar nga niveli bachelor deri në nivelin PhD ose post doktoratë;
2. Stafi akademik, pedagogë për nivelin PhD dhe Post Doktoraturë;
3. Stafi administrativ për 1 muaj shkëmbim përvojë;
4. Kandidatë të tjerë nga universitete jopartnere shqiptare duke filluar nga niveli Master deri në PhD ose post doktoraturë. Konkretisht:

Programi i studimit “*Basileus*” përfshin shkëmbimet për:

- Bachelor: 1 semestër deri në 1 vit;
- Master: 1 semestër deri në 2 vjet;
- PhD: 6 muaj deri në 34 muaj;
- Postdotoraturë: 6 muaj deri në 10 muaj;
- Staf administrativ: 1 muaj.

Programi i studimit “*JOIN EU SEE*” ndahet në 3 (tri) kategori:

1. Shkëmbime me transferim të krediteve ku përfshihen nivelet:
 - Bachelor: 1 semestër deri në 1 vit akademik;
 - Master: 1 semestër deri në 1 vit akademik;
 - PhD: 6 muaj deri në 10 muaj.
2. Programe studimi të plota afatgjatë:
 - Master deri në 2 vite akademikë (24 muaj) në varësi të programit të studimit;
 - PhD në tre vite akademikë (36 muaj) në varësi të programit të studimit.
3. Programe studimi afatshkurtër në postdotoraturë për një periudhë kohore nga 6-10 muaj.

Afatet e aplikimit online për “*Basileus*” është data 2 shkurt 2014 dhe për “*Join EU-SEE*” është data 1 shkurt 2014.

Bursa e studimit mbulon të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të pjesëmarrjes (akomodim dhe ushqim), si dhe shpenzimet për siguracionin shëndetësor.

Për më tepër informacion lidhur me mënyrën e aplikimit dhe udhëzimeve përkatëse për programet "Basileus" dhe "Join EU-SEE", referojuni adresave të faqeve elektronike në vijim:

[http://www.basileus.ugent.be/index.asp?p=2018&a=2018;](http://www.basileus.ugent.be/index.asp?p=2018&a=2018)

[http://www.joineuseepenta.eu/scholarship/hoë-long-can-i-stay/;](http://www.joineuseepenta.eu/scholarship/hoë-long-can-i-stay/)

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE NDËRKOMBËTARE